

PUNA E EULEX-IT LIDHUR ME PERSONAT E ZHDUKUR



EULEX Kosovo dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore

Sipas të dhënave të datës 14 qershor 2024, mbi 1600 persona ende figurojnë të zhdukur në lidhje me konfliktin në Kosovë; familjarët e tyre kanë të drejtën të dinë të vërtetën.

Ekspertët mjekoligjorë të EULEX-it punojnë krah për krah me homologët e tyre vendas në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe institucionet e tjera përkatëse të Kosovës për **zbardhjen e fatit të personave të zhdukur** pavarësisht rrethanave të zhdukjes së tyre, përkatësisë etnike, fetare apo prejardhjes kombëtare, apo çfarëdo karakteristike tjetër të tyre.

Roli i Misionit është të iu ndihmojë institucioneve të Kosovës në dhënien e përgjigjeve familjarëve dhe më të dashurve të personave të zhdukur dhe realizimin **e të drejtës së tyre për ditur të vërtetën.**



Zbardhja e fatit të personave të zhdukur është obligim i vazhdueshëm. Që nga fillimi i mandatit të tij e deri më sot, EULEX-i ka punuar pandarë për gjetjen e mbetjeve mortore të personave të pagjetur dhe kthimin e tyre tek familjarët me qëllimin që ata të mund të varrosen me nder dhe dinjitet.

- EULEX-i ofron ekspertizë dhe këshilla **për identifikimin e varreve klandestine dhe të pashenjura dhe për zhvarrosjen dhe identifikimin e viktimave** të raportuar si të zhdukur gjatë periudhës 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000 si pasojë e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
- Misioni po ashtu e mbështetë IML-në **për rishikimin e mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës.**



NGA FILLIMI I MANDATIT TË EULEX-it DERI MË 14 QERSHOR 2024

MISIONI KA MARRË PJESE NË
MËNYRË AKTIVE NË 804 OPERACIONE
NË TERREN PËR LOKALIZIMIN
E PERSONAVE TË ZHDUKUR



DUKE PËRFSHIRË
210 ZHVARRIME

JANË IDENTIFIKUAR
MBETJET MORTORE
TË 507 PERSONAVE



PËRFSHIRË
348 PERSONA TË ZHDUKUR



Puna që është bërë deri më sot

Pas konfliktit në Kosovë, ekspertët mjekoligjorë ndërkombëtarë dhe vendorë kanë gjetur një numër domethënës të mbetjeve mortore në lokacionet si në vijim në Kosovë dhe Serbi:

LOKACIONI	NUMRI I TRUPAVE TË ZHVARROSUR
● Brekoc	121
● Çikatovë e Vjetër	112
● Rakosh	97
● Qirez	96
● Studime e Epërme	93
● Korishë	72
● Suhodoll i Poshtëm	70
● Çikatovë e Vjetër (1)	68
● Makoc	63
● Suhodoll	61
● Krushë e Madhe	58
● Rudnicë	54
● Suharekë	54
● Çikatovë e Vjetër (2)	50
● Kizhevak ¹	7

¹ Sqarimi për Kizhevakun: ekspertët e EULEX-it e përshkruajnë mënyrën se si e identifikuan ata lokacionin e saktë ku u zbuluan mbetjet mortore - Komunikata për Shtyp - EULEX - European Union Rule of Law Mission in Kosovo (eulex-kosovo.eu)

Sfidat

Një nga sfidat kryesore të hasura nga ekspertët mjekoligjorë gjatë procesit të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur të Kosovës është fakti se një numër i konsiderueshëm i viktimave qëllimisht janë **varrosur nga kryerësit e veprave në varre të vogla, klandestine**, disa prej tyre edhe nëpër varreza, për të vështirësuar kërkimin e personave të zhdukur si dhe për të fshehur provat e krimeve të tyre.²



² "Të fshehësh trupin e një personi të pagjetur në një varrezë është njësoj sikur ta fshehësh një libër në bibliotekë. Është shumë e vështirë për ta gjetur". – Ekspertët e EULEX-it për sfidat në gjetjen e personave të pagjetur të varrosur nëpër varreza - Komunikata për Shtyp - EULEX - European Union Rule of Law Mission in Kosovo (eulex-kosovo.eu)

Pasqyrë e numrit të trupave të zhvarrosur në katër varreza

VARREZA	NUMRI I TRUPAVE TË ZHVARROSUR
● Varrezat ortodokse në Arbëri (<i>Prishtinë</i>)	81
● Varrezat e Prizrenit	77
● Varrezat e Shirokos	59
● Varrezat myslimane në Arbëri (<i>Prishtinë</i>)	49





Përveç sfidës së përmendur më sipër që është hasur nga ekspertët mjekoligjorë gjatë procesit të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur, janë edhe disa sfida të tjera të mëdha, si:

- **Mungesa e informatave të reja dhe të besueshme** për lokacionet e varreve;
- Fakti që jo të gjitha familjet e personave të zhdukur kanë dhënë **mostra gjaku** për analizë të ADN-së;
- **Kufizimet e analizës së ADN-së në vitet e para.** Së pari, në vitet e para pas konfliktit në Kosovë, analiza e ADN-së nuk ishte në dispozicion menjëherë. Përveç kësaj, përparimet në teknologjinë e ADN-së përgjatë viteve mund të mundësojnë rezultate të reja që nuk ishin të arritshme në të kaluarën, gjë që mund të sjellë deri te një identifikim i ri;
- Çështja e **identifikimeve të gabuara.** Në periudhën e pasluftës, trupat ishin identifikuar në mënyra të shpejta, për shembull përmes fotografive apo rrobave, gjë që ka rezultuar në gabime të cilat tani është e vështirë të gjurmohen dhe të përmirësohen.



Rishikimi i mbetjeve mortore në morgun e Prishtinës

Ekspertët e EULEX-it punojnë së bashku me autoritetet e Kosovës për të bërë një rishikim të mbetjeve mortore në morgun e Prishtinës.

Rishikimi në proces i rasteve në morgun e IML-së bashkërendohet nga **një grup punues nën udhëheqjen e ekspertëve mjekoligjorë të IML-së.**

Ky proces ka dy objektiva kryesore:

- të bëhet rishikimi i çdo mbetje mortore;
- rishikimi i dosjeve përkatëse të rasteve.

Qasja strategjike për rishikimin e njëkohshëm të mbetjeve mortore dhe të dosjeve përkatëse të rasteve do t'ia bëjë të mundur IML-së që të vlerësojë nëse të gjitha informatat që janë në dispozicion deri më sot për secilin rast janë shqyrtuar dhe, për shembull, nëse është e nevojshme marrja e mostrave të reja për analizë të ADN-së apo nëse një gjë e tillë është e mundur të bëhet.

Në fillim të mandatit të EULEX-it, një prej sfidave dhe prioriteteve më të mëdha ishte trajtimi i mbetjeve mortore që janë gjetur dhe grumbulluar për pothuajse dhjetë vite dhe që mbaheshin në morgun e IML-së në kushte të ndryshme. Gjatë viteve të para të Misionit, ishin bërë punë gjithëpërfshirëse për inventarizimin e atyre mbetjeve mortore dhe, aty ku ekzistonin, pistat ishin ndjekur duke rezultuar me identifikimin e një numri të rasteve. Një numër tepër i madh i rasteve, megjithatë, ishin raste shumë sfiduese dhe pavarësisht përpjekjeve, ato ende vazhdojnë të jenë të paidentifikuara.



Me procesin aktual të rishikimit, do të bëhet edhe një shqyrtim i historisë së secilit rast dhe i të gjitha informatave që mund të merren prej arkivave të qasura rishtazi rreth ngjarjeve të ndërlidhura dhe grupeve të personave që janë zhdukur njëkohësisht, dhe shpresat janë që pista të reja të mund të gjenden dhe të zgjidhen.

Rishikimi i të gjitha mbetjeve mortore të ruajtura në morg dhe i të gjitha dosjeve të rasteve të ndërlidhura do të mundësojë përcaktimin e statusit të azhurnuar të të gjitha rasteve, posaçërisht të rasteve të ndërlidhura me konfliktin që janë të interesit mjekoligjor, por edhe të rasteve të interesit mjekoligjor që nuk janë të ndërlidhura me konfliktin dhe rasteve që nuk janë të interesit mjekoligjor.

Familjarët e personave të zhdukur mund të ndihmojnë punën e IML-së përmes dhënies së mostrave referente të gjakut, nëse ato mostra nuk janë dhënë ende, dhe përmes dhënies së informatave në lidhje me personin e zhdukur apo ngjarjen e zhdukjes. Gjithashtu, familjet mund të na kontaktojnë për ndonjë sqarim apo kërkesë për informata.


KONTAKTE TË DOBISHME

INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

 +383 (0)38 200 18 555

 info@mjekesialigjore-ks.com

EULEX

 +383 (0)38 78 4000

 info@eulex-kosovo.eu



www.eulex-kosovo.eu